



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr. **67/2024**

Data: **11.12.2024. Ora: 14: 00**

Vendi: **Procedure qarkulluese e mbledhjes**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,  
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITËS**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

---

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ Nr. 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66**

---

**3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ**

---

---

#### **4. Aktivitetet e Zyrës**

4.1. Njoftim për periudhën e aplikimit për certifikim të subjekteve politike

---

#### **5. Raport i Këshillave të KQZ**

---

##### **5.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

5.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim dhe Edukim për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 09.02.2025

5.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i nominimit për zëvendësim të anëtarit të KKZ-së komuna Leposaviq

5.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për vëzhguesit e TMZ dhe organizatave të specializuara në fushën e zgjedhjeve për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 09.02.2025

5.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Trajnimit

5.1.5. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Pako Trajnimit

5.1.6. Kërkesë nga ZEKKZ komuna Istog për Qendrën Votimit me Kusht

5.1.7. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit nga ZEKKZ komuna Kaçanik për qendrën e votimit 0719

5.1.8. Raport lidhur me analizimin e të dhënave nga Ekstrakti i dytë i Regjistrimit Qendror Civil

5.1.9. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës si dhe Vlerësimi i Pakove me Fletëvotime

---

#### **6. Të ndryshme**

---

1. **Hyrie: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ Nr. 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66

Në hapje të mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti rendin e ditës. Anëtarët e KQZ-së, e miratuan rendin e ditës me 10 vota.

Në pikën e dytë, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalet: 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66. Sami Kurteshi, e votoi vetëm procesverbalin nr. 66. Në vazhdim, u pasqyruan aktivitetet e sekretariatit.

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ**

**Besnik Buzhala**, u.d. i Sekretariatit, tha se periudha e kundërshtimit dhe e confirmimit të listës votuese ka filluar më datën 29 gusht 2024 dhe se sekretariati nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për kundërshtim të LV -së. Ndërsa, periudha e ndërrimit të qendrës së votimit konsiston në faktin se deri më sot, 11.12.2024, janë pranuar gjithsej: 3,208 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit. Kërkesat përmes sistemit elektronikë janë 2,528, ndërsa 680 janë bërë në zyrat e komisioneve komunale përmes formularëve. Nga 2,236 kërkesa për ndërrimin e QV-ve, janë aprovuar 2,161 kërkesa, kurse janë refuzuar 115 kërkesa për arsye se nuk kanë bashkangjitur fotografinë me dokument identifikues në dorë.

Lidhur me periudhën e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike dhe postës deri sot në ora 09:00, kanë aplikuar 33,533 votues: 30,656 kërkesa janë aprovuar, 1,990 kërkesa janë refuzuar, dhe kërkesa 887 janë anuluar.

Lidhur me votimin jashtë Kosovës, përmes grafikimeve, raporti pasqyron numrin e aplikantëve nga shtetet e ndryshme, ashtu si edhe elementet e tjera të procesit.

Lidhur me raportin, **Ilir Gashi** pyeti se a ka ndonjë përgjigje, të dhëna nga “fahu postal” sepse subjektet duhet ti kenë edhe vëzhguesit e tyre, dhe se a ka ndonjë të dhënë se ku janë bërë hapjet e “faheve postare”.

Besnik Buzhala tha se, nuk ka ndonjë informacion në këtë drejtim.

**Alban Krasniqi**, pyeti mbi aplikime të veçuara në shtetet e caktuara si Gjermani, Zvicër etj. **Buzhala**, tha se nuk janë bërë raporte të këtilla por, zyra do ti ndaj dhe raportoje statistikave të aplikimeve nëpër shtete e ndryshme në një raport të ardhshëm. Më tej, në elaborimin e kësaj pike, z. Krasniqi, pavarësisht se mund të shfaqen probleme apo pengesa, tha se fton bashkatdhetarët që të aplikojnë për votim.

### 3. Aktivitetet e Zyrës

#### Njoftim për periudhën e aplikimit për certifikim të subjekteve politike:

**Besnik Buzhala**, lidhur me këtë pikë të mbledhjes tha se periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe e kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka filluar me datën 1 shtator 2024 dhe përfundon sot, me datën 11 dhjetor 2024, ora 16:00. Në lidhje me aplikimin për certifikim të subjekteve politike, Buzhala tha se deri nga 1 shtatori 2024, e deri në këto momente, aplikimin për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve e kanë përfunduar dhjetë (10) subjekte politike:

1. Subjekti politik i regjistruar JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA JGP (datë 09.12.2024) me gjithsejtë: njëzet e nëntë (29) kandidatë: njëzet (20) kandidatë burra, ose 69%, nëntë (9) kandidate gra, ose 31%. 2. Subjekti politik i regjistruar PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM PAI (datë 10.12.2024) me gjithsejtë: me gjithsejtë: tridhjetë e pesë (35) kandidatë: njëzet e katër (24) kandidatë burra, ose 69%, njëmbëdhjetë (11) kandidate gra, ose 31%. 3. Subjekti politik i regjistruar Srpska demokratija (datë 10.12.2024) me gjithsejtë: trembëdhjetë (13) kandidatë: nëntë (9) kandidatë burra, ose 69%, katër (4) kandidate gra, ose 31%. 4. Iniciativa qytetare GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA (datë 10.12.2024) me gjithsejtë: dhjetë (10) kandidatë: shtatë (7) kandidatë burra, ose 70%, tri (3) kandidate gra, ose 30%. 5. Iniciativa qytetare OPRE ROMA KOSOVA (datë 10.12.2024) me gjithsejtë: dymbëdhjetë (12) kandidatë: shtatë (7) kandidatë burra, ose 58%, pesë (5) kandidate gra, ose 42%. 6. Subjekti politik i regjistruar Za Slobodu Pravdu i Opstanak (datë 10.12.2024) me gjithsejtë: dymbëdhjetë (12) kandidatë: tetë (8) kandidatë burra, ose 67%, katër (4) kandidate gra, ose 33%. 7. Subjekti politik i regjistruar Yenilikçi Türk Hareket Partisi (datë 11.12.2024) me gjithsejtë: njëzet e pesë (25) kandidatë: dymbëdhjetë (12) kandidatë burra, ose 48%, trembëdhjetë (13) kandidate gra, ose 52%. 8. Subjekti politik i regjistruar Partija kosovskih Srba (datë 11.12.2024) me gjithsejtë: nëntë (9) kandidatë: pesë (5) kandidatë burra, ose 56%, katër (4) kandidate gra, ose 44%. 9. Subjekti politik kandidat i pavarur FATMIR BYQYQI. 10. Subjekti politik i regjistruar KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ (datë 11.12.2024) me gjithsejtë: njëzet e pesë (25) kandidatë: gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë burra, ose 64%, nëntë (9) kandidate gra, ose 36%.

Për subjektet politike që kanë aplikuar deri më tani, ashtu siç përcaktohet në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Zyra ka dërguar për të dhënat për verifikim. Pas pranimit të rezultateve të verifikimit dhe varësisht plotësimeve që ndodhin, Zyra do të rekomandoj në

KQZ, certifikimin ose jo të subjekteve politike që kanë aplikuar për certifikim në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen me datën 09.02.2025.

#### **4. Raport i Këshillave të KQZ**

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

###### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim dhe Edukim për Zgjedhjet për**

**Kuvendin e Republikës së Kosovës 09.02.2025:**

**Arianit Elshani**, në raportin e gjerë të këshillit paraqiti disa pika të KOZ-it. Me këtë rast, ai tha se është shqyrtuar plani i informimit dhe i edukimit për zgjedhjet. Ai, pasqyroi pikat e rëndësishme të planit dhe ftoi KQZ-në ta miratoj këtë plan.

**Alban Krasniqi**, tha se të sigurohemi që kërkesat e ngritura nga këshilli të përfshihen dhe ne, ti aprovojmë tërësisht.

Anëtarët e KQZ, me 10 vota për u miratua ky plan.

###### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i nominimit për zëvendësim të anëtarit të KKZ-së**

**komuna Leposaviq:**

**Arianit Elshani:** Këshilli, tha z. Elshani e ka shqyrtuar një kërkesë për zëvendësim. Bëhet fjalë për Daniella Vuqiniqin e cila zëvendësohet nga Ivzo Islamoviq nga GISPO.

Anëtarët e KQZ, me 10 vota për u miratua ky zëvendësim.

###### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për vëzhguesit e TMZ dhe organizatave të specializuara në fushën e zgjedhjeve për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 09.02.2025:**

**Arianit Elshani:** Këshilli, ka shqyrtuar edhe këtë pikë dhe se është propozuar një projekt që ka për qëllim të organizohet një sesion i disa aktiviteteve – vizitave të ndryshme të vëzhguesve të atyre që vijnë nga jashtë. Kjo, pasqyron një informacion të gjerë, njohje, si dhe hapjen e KQZ-së brenda procesit. Bëhet fjalë

për 3 organizata të specializuar në fushën e zgjedhjeve (AËEB, IDA, dhe IFES), si dhe trupave të vëzhguese nga shtetet e ndryshme. Ka buxhet të ndarë...

Me 10 vota për, miratohet.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Trajnimit

**Arianit Elshani:** E kemi shqyrtuar dhe trajtuar edhe këtë plan me rëndësi, bazuar me ndryshimet që kemi bërë, me module të reja etj. Rekomandojmë për miratim:

Me 9 vota për, miratohet plani i trajnimit.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Pako Trajnimit:

**Arianit Elshani:** Po ashtu, KOZ ka shqyrtuar edhe specifikat për shtypjen e pakove të trajnimit. Tani, ne kemi konsideruar se ka pasur materiale të tepërta, por edhe të pakta në numër. Besoj, kemi përsirë procedura të reja-pako në përputhje me ndryshimet dhe kjo, konfirmon plotësimet, kriteret dhe specifikat ndryshe nga e kaluara.

Me 9 vota për, meritohen specifikat e trajnimit.

6. Kërkesë nga ZEKKZ komuna Istog për Qendrën e Votimit me Kusht:

**Arianit Elshani:** Kemi shqyrtuar ndërrimin e dy qendrave me kusht. Janë dy shkollat, dhe qendra e votimit të rregullt të jetë në shkollën "Haxhi Zeka", ndërsa shkolla tjetër "Bajram Curri" kishte 3 objekte të mundeshe, dhe aty kemi vendosë që të jetë qendra komunale e votimit dhe qendra e votimit me kusht.

Me 9 vota për, meritohen qendra e votimit me kusht.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit nga ZEKKZ komuna Kaçanik për

qendrën e votimit 0719:

**Arianit Elshani:** Kemi shqyrtuar qendrën e votimit në Gjurgjedel, për shkak se objekti ku ishte deri më tani qendra e votimit më nuk është në gjendje të mirë, është i dëmtuar. Kemi konsideruar që të merren masat e informimit, dhe votuesit të bartën në qendrën e votimit në Kaçanik, në dalje në drejtim të Shkupit.

**Alban Krasniqi:** Me këtë rast, e kam fjalën edhe për zyrtarët tanë por edhe për kryesuesin e KKZ-së që, pa gjetur zgjidhje me imponue vendimarrje nga KQZ. Pa gjetur zgjidhje. Ne, i kemi qartësue rrugët që duhet ndjekur, por formati i kërkesës që na ka ardhë është i njëjtë. Duhet një analizë, sa banorë janë, sa prej tyre

do informohen, a ka mundësi me u bartë në një qendër tjetër etj. Ju po thoni nuk janë votuesit, ku janë ata...? Unë, nuk votoj me u heqë kjo qendër deri sa nuk merren masat e duhura. Ka 2 muaj kjo çështje, dhe nuk janë ndërmarrë masa të duhura. Sa janë, 65 votues, në zona të thella si kjo, është goxha numër real...

Unë, ju ftoj mos ta votoni, deri sa nuk kemi një raport konkret.

Diskutuan lidhur me këtë pikë: Ilir Gashi, në diskutimin e tij propozoi që Sekretariati ta bëjë një komision dhe le të shkoj ta verifikoj kërkesën, gjendjen etj. Ibrahim Selmanaj, tha se kryesuesi na e ka shpjeguar gjendjen se, atje nuk ka objekt, nuk ka rrymë, internet etj. Por, ku nuk ka banorë, nuk ka votues nuk duhet hapur si qendër. Qemailj Kurtis, tha se unë propozoj që brenda javës të shihet edhe njëherë, të shihet a ka alternativë tjetër. Votuesit mund të verifikohet. Të mos e votojmë tani, dhe pas një jave të shohim si do të veprojmë...

Alban Krasniqi: Ne, nuk e dimë gjendjen. Banorët, e din si është gjendja atje. Por, ne nuk duhet të përfundojmë duke mbyllur qendra, se mund të ketë edhe raste tjera ! Arianit Elshani: Nëse konsideroni që duhet të kthehet prapa, të shihet prapë mirë, por nuk kisha dashur të merrem më tutje me këtë pikë. Konsideroj që jemi vonë edhe me data, prandaj kemi konsideruar se duhet ta rekomandojmë për miratim.

Besnik Buzhala, tha se mund të kemi burime zyrtare, raporte lidhur me numrin e banorëve. Për një javë, ne mund ta kemi një raport më konkret.

Kreshnik Radoniqi: Kjo pikë, të nderuar anëtarë, tërhiqet nga votimi...

#### 8. Raport lidhur me analizimin e të dhënave nga Ekstrakti i dytë i Regjistrit Qendror Civil:

**Arianit Elshani:** Departamenti i teknologjisë ka krijuar një raport, ka analizuar të dhënat statistikore – data bazën e dokumenteve të prodhimit, dhe atë të gjendjes civile. Nga të dhënat krahasuese, ka dalë se 37, 423 personave iu dallon komuna nga gjendja civile në departamentin e prodhimit të dokumenteve. Kjo data bazë, përbëhet nga 2 milion e 76 mijë e 130 persona. Lista votuese, ka këtë shifër sipas shërbimit votues.

Kjo listë, përbëhet vetëm nga shtetas të Republikës së Kosovës. Kjo listë, konsiderojmë se nuk e lenë askënd jashtë por, do i mundësohet secilit të votoj...

Konsideroj që edhe pas miratimit, duke filluar nga sot përmes informimit që të njoftohen votuesit lidhur me këtë ndryshim, dhe kjo e përmirëson dukshëm listën.

**Sami Kurteshi**, pyeti rreth llojeve – statistikave - kategorive që e përbëjnë në tërësi listën. A ka arritur të pastrohet deri diku lista ? Personat që i mbushin 18 vjet, për shembull në mërgatë, nuk mund të votojnë sepse, nuk kanë aplikuar. Çka ndodh me ta ?

**Besnik Buzhala**: Është kriteri, pra të gjithë ata persona që më 9 gusht i mbushin 18 vjet, pra nuk ka rëndësi se ku ai jeton.

Me 9 vota për, miratohet.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës si dhe Vlerësimi i Pakove me Fletëvotime:

**Arianit Elshani**: Është krijuar procedura që rregullon shqyrtimin e aplikacioneve, të pakove. Janë parapa kriteret, sepse ka pasur tendenca për manipulime me fletëvotime. Pra, tani janë kritere të tjera veprimi, dhe verifikimet janë në nivel të lartë. Rekomandojmë që këto procedura të miratohen nga KQZ.

Në këtë pikë diskutuan: Ilir Gashi, Fazli Stollaj...

*( Regjistrimi teknik i mbledhjes ka ndërprerje...! )*

---

Në këtë mbledhje, anëtarët e KQZ-së kanë diskutuar edhe lidhur me përfundimin e afatit për aplikimit të subjekteve politike me listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në zgjedhje. Afati, sipas planit operacional të KQZ-së, është paraparë deri në ora 16:00. Në fund, është votuar për propozimin e shtyrjes së afatit.

**Kreshnik Radoniqi**: E kemi propozimin për zgjatjen e afatit për aplikim deri në ora 23: 59. Kush është për...?

Për këtë propozim, votuan 8 anëtarë të KQZ-së dhe një votë ishte kundër ! Ndërsa, kryetari Radoniqi, votoi kundër ( 1 votë kundër zgjatjes së afatit).

## 5. Të ndryshme !



